

VENDIM
Nr. 706, datë 13.11.2024

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN
2024, NDËRMJET KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT DHE
MINISTRISË SË DREJTËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2024 bëhet rishpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:
 - a) Ministrisë së Drejtësisë i shtohet fondi prej 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekësh, në programin buxhetor “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi” (01110), artikulli 602, i cili do të përdoret nga Arkivi Shtetëror i Sistemit të Drejtësisë për arkivimin e dokumentacionit të rivlerësimit kalimtar të magjistratëve;
 - b) Komisionit të Pavarur të Kualifikimit i pakësohet fondi prej 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekësh, në programin buxhetor 03330, artikulli 602.
 2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama